

BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE

RAPORTE FINANCIARE PERIODIKE

(Sipas kerkesave te rregullores Nr.60, date 29.08.2008 te Bankes se Shqiperise)

Tremujori i I-rë, 2015

Data e publikimit: 22 Prill, 2015

PERMBAJTJA:

1. Tregues te rentabilitetit te bankes
2. Bilanci dhe zerat jashte bilancit te permbledhura
3. Pasqyra e te Ardhurave
4. Fluksi i rrjedhjes se parase
5. Pasqyra e ndryshimit te Kapitalit Aksioner
6. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas sektoreve
7. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas tipit te industrise
8. Klasifikim i portofolit te kredive sipas shperndarjes gjeografike
9. Fondet per provigjone dhe levizjet gjate periudhes
10. Aktivitet sipas maturitetit perfundimtar
11. Pasivet sipas maturitetit perfundimtar
12. Kapitali rregullator per mbulimin e rreziqeve te kredise
13. Zerat e Aktivitet dhe zerat jashte bilancit te ponderuara me riskun
14. Raporti i mjaftueshmerise se kapitalit
15. Krahasimi i madhesis se kapitalit rregullator te bankes me kerkesen per kapital rregullator per mbulimin e rrezikut te tregut, te lidhur me normat e interesit
16. Kerkesa per kapital rregullator per mbulimin e riskut te tregut te lidhur me kembimet ne valute
17. Shenime per pasqyrat financiare

1. Treguesit e rentabilitetit

Banka e Bashkuar e Shqiperise		Mars 2015	Dhjetor 2014	Shtator 2014	Qershor 2014	Mars 2014
Tregues te rentabilitetit te bankes						
1	Kthyeshmeria nga aktivet mesatare (ROAA) (Te ardhurat neto / aktivet mesater*100)	0.7%	0.3%	0.4%	0.4%	0.4%
2	Shpenzime te pergjithshme te veprimtarise / te ardhurat bruto te veprimtarise	86%	93%	93%	93%	92%
3	Te ardhurat neto nga interesi / / shpenzimet e pergjithshme te veprimtarise	45%	43%	29.00%	25.00%	21.63%
4	Kthyeshmeria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) (te ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar*100)	3.9%	1.4%	2.1%	2.3%	2.6%
5	Aktive per punonjes (totali I aktiveve / / numri I rregjistruar I punonjesve) ne Lek'000	94,336	84,293	94,412	92,691	92,487
6	Te ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare	0.49%	2.43%	1.09%	0.64%	0.27%
7	Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare	0.73%	4.24%	2.39%	2.75%	2.62%
8	Shpenzimet per interesa / aktivet mesatare	0.2%	1.8%	1.3%	1.9%	1.92%
9	Te ardhurat neto nga interesat / / te ardhurat bruto te veprimtarise	39%	40%	27%	23%	19.92%
10	Te ardhurat neto nga veprimtarite e tjera / aktivet mesatare	0.2%	1.1%	0.8%	1.1%	1.17%
11	Shpenzimet jo per interesa / / te ardhurat bruto te veprimtarise	68%	63%	61%	59%	57.06%
12	Shpenzime personeli / / te ardhurat bruto te veprimtarise	31%	23 %	23 %	21.1%	21.15%
13	Shpenzime per provigjone / aktive mesatare	0.3%	1%	1%	0.7%	0.32%
	Rimarrje					

2. Bilanci dhe zerat jashte bilancit te permbledhura

Banka e Bashkuar e Shqiperise
Bilanci kontabel dhe zerat jashtë bilancit
shprehur ne mije leke

AKTIVET	Mars 2015	Dhjetor 2014
VEPRIMET THESARI & NDËRBANKARE	4,137,033	3,989,095
Arka dhe Banka qendrore	1,070,116	1,005,205
Bono thesari	781,506	955,604
Llogari rrjedhese ne bankat, instituc. Financiare	1,205,118	1,054,892
Depozita me bankat, institucionet financiare	740,274	693,377
Hua per Bankat & Institucione financiare	340,019	280,017
VEPRIMET ME KLIENTËT	1,479,169	1,403,726
Hua standarte per klientët	1,382,197	1,295,976
Hua ne ndjekje	54,391	60,684
Hua nenstandart	28,648	26,836
Fonde rezervë për huatë nenstandart	(6,278)	(6,035)
Hua të dyshimta	40,487	52,598
Fonde rezervë për huatë e dyshimta	(20,277)	(26,333)
Hua të humbura	551,064	549,845
Fonde rezervë për huatë e humbura	(551,064)	(549,845)
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	392,699	368,143
MJETET E PËRHERSHME	326,205	308,131
Interesa pjesëmarrëse	112,864	99,558
Mjete të qëndrueshme	213,341	208,573
TOTALI I AKTIVEVE	6,335,106	6,069,095

PASIVET	Mars 2015	Dhjetor 2014
VEPRIMET E THESARIT & NDËRBANKARE	126,380	46,084
Llogari rrjedhëse me bankat, institucionet financiare	8,696	306
Depozita nga bankat, institucionet financiare	81,398	23,360
Hua marre nga Bankat dhe institucionet e kreditit	36,286	22,418
VEPRIMET ME KLIENTËT	4,693,503	4,725,349
Qeveria Shqiptare & administrata publike	12,297	13,277
Detyrime ndaj klientëve për llogaritë	4,681,207	4,712,072
Llogari rrjedhëse	1,135,741	1,017,173
Llogari depozitash me afat	3,545,301	3,687,523
Llogari të tjera të klientëve	165	7,376
DETYRIME TË TJERA	24,365	21,834
BURIME TË PËRHERSHME	1,490,858	1,275,829
Fondet rezervë specifike	17,552	17,059
Kapitali i aksionerëve	1,473,305	1,258,770
<i>Kapitali i paguar*</i>	1,762,717	1,762,717
<i>Primet e aksioneve</i>	-	-
<i>Rezerva</i>	131,581	131,581
<i>Diferenca e rivlerësimit</i>	(45,771)	(248,182)
<i>Fitimi (humbja) i pashpërndarë</i>	(387,345)	(405,958)
<i>Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor</i>	12,124	18,613
TOTALI I PASIVEVE	6,335,106	6,069,095

ZËRAT JASHTË BILANCIT	Mars 2015	Dhjetor 2014
ANGAZHIME FINANCIMI	10,653	658
Angazhime të dhëna		

	10,653	5,520
Angazhime të marra	-	-
GARANCITË	5,338,979	4,812,249
Garanci të dhëna	23,796	45,003
Garanci të marra	5,315,183	5,287,086
TRANKSAKSIONE NE VALUTE	76,719	
Valutë e blerë me afat	38,366	-
Valutë e shitur me afat	38,353	-
TOTALI	5,426,351	5,337,609

3. Pasqyra e te ardhurave

RREZULTATI FINANCIAR	3 mujori i mbyllur ne 31/03/2015	3mujori i mbyllur ne 31/03/2014
Interesat		
<i>Të ardhura nga interesat</i>	49,511	51,493
Për veprimet me bankat	6,312	13,664
Nga veprimet me klientët	36,222	30,909
Nga veprimet me letrat me vlerë	6,976	6,920
<i>Shpenzime per interesa</i>	(15,938)	(32,826)
Për veprimet me bankat	-	-
Per veprimet me klientët	(15,938)	(32,826)
Per veprimet me letrat me vlerë	-	-
Total interesat	33,573	18,666
Te ardhurat nga komisionet	6,563	4,464
Nga veprimtaria huadhenese	1,663	667
Nga sherbimet bankare	4,901	3,797
Shpenzime per komisionet	(330)	(399)
Per veprimtarine huadhenese	-	-
Per sherbimet bankare	(330)	(399)
Fitim/Humbja komisionet neto	6,234	

		4,065
Fitim / Humbja neto nga veprimtaria valutore	9,241	13,949
Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare	-	(63)
Shpenzime për personelin	(26,745)	(19,817)
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	(742)	(1,185)
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(26,539)	(24,439)
Amortizimi i mjeteve të qëndrueshme	(4,598)	(7,549)
<i>Shpenzime për fonde rezervë për huatë standarde & ndjekje</i>	(1,414)	(119)
<i>Shpenzime fonde rezervë për huatë nenstandarde, dyshimta, humbje</i>	(4,852)	(10,075)
Rimarrje nga fonde rezerve per huate standarte& ndjekje	1,672	398
Rimarrje nga fonde rezerve per huate nenstandarte, dyshimta, humbura	25,249	31,972
Shpenzime te tjera per Fonde Rezerve	-	-
Llogari per t'u arketuar te pambledhshme	-	-
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare	1,023	911
Fitimi neto nga veprimtarite jo te zakonshme	24	693
Te ardhura jo te zakonshme	24	693
Shpenzime jo te zakonshme	-	(20)
Fitimi para tatimit	12,124	7,405
Tatimi	-	-
FITIMI NETO	12,124	7,405

4. Fluksi i rrjedhjes se parase

	Mars 2015	Dhjetor 2014
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative		
Humbja neto e periudhes (para taksave)	12,124	26,467
Rregullimet për zërat jo monetarë:		
Zhvlerësimi	4,598	29,522
Zhvlerësimi i rregullimeve të pronave me qira	-	366
Provizjon për humbjet dhe provizjon statistikor	(20,656)	(49,699)

Provizjon për humbjet nga fondet e investimit	-	1,900
Ndryshim në diferencën e rivlerësimit për kapitalin	-	6,627
Të ardhura nga aktive financiare	(49,511)	(257,196)
Shpenzime për pjesëmarrjen e klientëve	15,938	109,478
	37,506	132,535
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:		
Pakesim/(rritje) në te drejtat nga aktivitetet financuese	(59,846)	(276,015)
Pakesim/(rritje) në aktivet e tjera	(4,246)	6,698
Pakesim/(rritje) në te drejtat ndaj bankave	(72,689)	488,429
Rritje në balancat e klientëve	48,151	64,954
Rritje/(pakesim) në detyrimet e tjera	(7,198)	(9,220)
Total	(95,828)	274,846
Tatim i parapaguar	(262)	(5,698)
E ardhura financiare e arkëtuar	46,902	258,632
Pagesa për pjesëmarrjen e klientëve	(25,913)	(147,986)
Para neto gjeneruar /(perdorur) në aktivitete operative	112,607	247,590
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		
Para gjeneruar nga blerja e bonove te thesarit	183,634	(236,410)
Blerja e aktiveve fikse neto nga nxjerrja jashte perdorimit	(9,366)	(5,755)
Para neto (përdorur)/gjeneruar nga aktivitete investuese	174,268	(242,165)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		
Rritje e Kapitalit Aksionar	-	-
(Pakesim)/rritje në detyrimet ndaj bankave	13,880	16,700
Para neto gjeneruar nga aktivitete financuese	13,880	16,700
Rritje neto ne para dhe mjete monetare të ngjashme	75,540	22,124
Impakti i kursit te kemibimit ne arke dhe zera te ngjashem	202,411	169,032
Para dhe mjete monetare të ngjashme në fillim të vitit	2,068,778	1,877,622
Para dhe mjete monetare të ngjashme në fund të vitit	2,346,729	2,068,778

5. Pasqyra e ndryshimit ne Kapitalin Aksionar

	KAPITALI AKSIONAR	REZERVA E RIVLERES IMIT	REZERVA LIGJORE	HUMBJA E MBARTUR	TOTAL
Gjendja me 31 dhjetor 2013	1,762,717	(423,911)	131,581	(405,960)	1,064,427
Ndryshime në rezervën e rivlerësimit	-	175,730	-	-	175,730
Rritje ne kapitalin aksioner	-	-	-	-	-
Fitim / (Humbje) e vitit	-	-	-	18,613	18,613
Gjendja me 31 dhjetor 2014	1,762,717	(248,182)	131,581	(387,710)	1,258,770
Ndryshime në rezervën e rivlerësimit	-	202,411	-	-	202,411
Rritja e kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Fitim/ (Humbje) e vitit	-	-	-	12,124	12,124
Gjendja me 31 Mars 2015	1,762,717	(45,771)	131,581	(375,586)	1,473,305

Ne date 31 Mars 2015, kapitali i regjistruar eshte 1,762,717 mije Lek i ndare ne 547,421 aksione me vlere nominale 3,220.04 lek ose 24.01USD per aksion. Gjate vitit 2015, nuk ka patur ndonje ndryshim ne kapitalin aksioner ne krahasim me vitin 2014.

6. Klasifikimi I portofolit te kredive sipas sektoreve

Kredi sipas sektoreve të ekonomisë (në mijë lekë)	Mars 2015
Kredi afatshkurtër	536,943
Lekë	199,931
Sektori shtetëror	
Sektori privat	197,350
Individët	2,581
Valutë	337,012
Sektori shtetëror	
Sektori privat	336,495
Individët	517
Kredi afatmesme	630,152
Lekë	335,551
Sektori shtetëror	
Sektori privat	300,589
Individët	34,962
Valutë	294,601
Sektori shtetëror	
Sektori privat	273,100
Individët	21,501
Kredi afatgjatë	751,866
Lekë	248,238
Sektori shtetëror	
Sektori privat	149,309
Individët	98,929
Valutë	503,628
Sektori shtetëror	-
Sektori privat	478,762
Individët	24,865
Totali	1,918,961

- Ky raportim eshte vetem per kredine dhene rezidentëve

7. Klasifikimi I portofolit te kredive sipas tipit te industries

Evidenca e kreditit sipas degëve të ekonomisë në mijë lekë Degët e ekonomisë	Mars 2015
Bizneset	1,735,605
Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura	53,344
Peshkimi	-
Industria nxjerrëse	-
Industria përpunuese	127,945
Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	10,180
Ndërtimi	441,271
Tregtia, Riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake	940,939
Hotelet dhe restorantet	4,522
Transporti, Magazinimi dhe Telekomunikacioni	22,955
Ndërmjetësim monetar dhe financiar	-
Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, etj.	-
Administrimi public	-
Arsimi	-
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	26,266
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale	95,123
Të tjera	13,059
	-
Individët	183,356
Kredi konsumatore	166,771
Kredi për blerje banesash	16,585
Totali	1,918,961

- *Kredi dhene rezidenteve*

8. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas shperndarjes gjeografike

QYTETET	SHUMA
Tirane	1,208,149
Durres	210,206
Shkoder	335,871
Fier	164,734
Total	1,918,961

9. Provigjonet e kredive

Provigjonet specifike

	31 Mars 2015	31 Dhjetor 2014
Gjendja ne fillim te vitit	582,213	654,233
(Rimarrje)/shtese gjatë vitit, neto	(20,397)	(89,931)
Efektet e këmbimit valuator	15,803	17,911
Gjendja ne date	577,619	582,213

Provigjonet statistikore

	31 Mars 2015	31 Dhjetor 2014
Gjendja ne fillim te vitit	17,059	18,653
(Rimarrje)/shtese gjatë vitit, neto	(258)	(2,664)
Efektet e këmbimit valuator	751	1,071
Gjendja ne date	17,552	17,059

Provigjonet per secilen klase te portofolit

	31 Mars 2015	31 Dhjetor 2014
Hua Standarte	14,810	14,001
Hua ne Ndjekje	2,742	3,058
Hua nen-standarte	6,278	6,035
Hu ate dyshimta	20,277	26,333
Hua te humbura	551,064	549,845
Total i provigjoneve per huate	595,171	599,272

10. Aktivet sipas maturitetit te mbetur

AKTIVET SIPAS MATURIMIT PËRFUNDIMTAR								
Treguesi	DITE	MUAJ				VITE		TOTALI
(në mijë lekë)	DERI 7	7 DITE 1 MUAJ	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
VEPRIME ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	2,226,699	751,627	359,174	425,613	373,920	-	-	4,137,033
Arka	329,342							329,342
Llogari rrjedhëse në bankën qendrore	288,668							288,668
Rezerva të detyrueshme	-	452,106	-					452,106
Depozita në bankën qendrore								-
Hua për bankën qendrore								-
Llogari të pakthyera në bankën qendrore								-
Llogari të tjera në bankën qendrore								-
Bono thesari		299,521	239,129	105,104	137,753			781,506
Bono të tjera të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore								-
Llogari rrjedhëse në institucione financiare	1,205,118							1,205,118
Depozita në institucione financiare	63,552	-	120,046	320,510	236,167			740,274
Hua për institucione financiare	340,019							340,019
Llog. të tjera në institucione financiare								-
Të dyshimta								-
VEPRIMET ME KLIENTËT	38,155	143,363	90,347	138,323	378,386	1,164,217	103,998	2,056,788
Hua standarte dhe paradhënie për klientët	29,232	140,808	76,842	133,673	368,731	528,912	103,998	1,382,197
Hua dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientët								-
Hua në ndjekje	8,922	2,555	13,505	4,650	9,654	15,106	-	54,391

Hua nënstandart						28,648		28,648
Hua të dyshimta						40,487	-	40,487
Hua të humbura						551,064		551,064
Llogari rrjedhëse të klientëve								-
Llogari të tjera të klientëve								-
Llogari për t'u arkëtuar të klientëve në status të dyshimtë të ndry. nga huatë	-							-
VEPRIME ME ADMINISTRATËN PUBLIKE	-	-	-	-		-	-	-
Llogari rrjedhëse								-
Llogari të tjera								-
TRANSAKSIONE TË LETRAVE ME VLERË	-	-	-	-		-	-	-
Letra me vlerë me të ardhura fikse	-					-		-
Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme								-
Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes së rishitjes REPO								-
Të tjera								-
MJETE TË TJERA	33,113	-	529	2,183	351,669	5,011		392,505
VEPRIMET SI AGJENT								-
LLOGARITË E MARRËDHËNIEVE								-
TË TJERA	194	-	-	-	-			194
MJETE TË QËNDRUESHME						326,205	-	326,205
Interesa pjesëmarrës dhe Filiale						112,864		112,864
Mjete të qëndrueshme të tjera						213,341		213,341
								-
TOTALI	2,298,161	894,990	450,050	566,119	1,103,975	1,495,433	103,998	6,912,725

11. Pasivet sipas maturitetit te mbetur

PASIVET SIPAS MATURIMIT PËRFUNDIMTAR	DITE	MUAJ				VITE		TOTALI
Treguesi	DERI 7	7 DITE 1	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
(në mijë lekë)								
VEPRIMET ME INSTITUCIONET FINANCIARE	8,696	26,501	-	-	54,897	36,286	-	126,380
Llogari rrjedhëse të bankës qendrore								-
Depozita të marra nga banka qendrore								-
Huamarrje nga banka qendrore								-
Llogari të tjera me bankën qendrore								-
Bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO								-
Bono të tjera të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO								-
Llogari rrjedhëse të institucioneve financiare	8,682							8,682
Depozita të marra nga institucionet financiare	-	26,501	-	-	54,897			81,398
Huamarrje nga institucionet financiare						36,286		36,286
Llogari të tjera të institucioneve financiare	14							14
VEPRIME ME KLIENTËT	1,284,154	284,963	368,496	1,280,322	1,288,265	175,007	-	4,681,207
Llogari rrjedhëse	1,135,741							1,135,741
Llogari depozitash pa afat	-							-
Llogari depozitash me afat	148,413	284,963	368,496	1,280,322	1,288,100	175,007		3,545,301
Llogari të tjera të klientëve	-	-	-	-	165	-		165

VEPRIME ME ADMINISTRATAT PUBLIKE	12,297	-	-	-	-	-	-	12,297
Llogari rrjedhëse	12,297							12,297
Llogari depozitash pa afat								-
Llogari depozitash me afat								-
Hua të marra nga administratat publike								-
Llogari të tjera të administratave publike								-
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	-	-	-	-	-	-	-	-
Borxhe të përfaqësuara nga letrat me vlerë								-
Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO								-
Të tjera								-
DETYRIME TË TJERA	4,983	3,701	1,212	-	-	-		9,896
VEPRIMET SI AGJENT								-
LLOGARI MARRËDHËNIESH								-
TË TJERA	14,469							14,469
BURIMET E PËRHERSHME	793	1,536	1,483	1,630	16,421	1,467,955	1,040	1,490,858
Ndihmat dhe financimi public								-
Fonde reserve	793	1,536	1,483	1,630	4,296	6,774	1,040	17,552
Borxh i varur								-
Kapitali i paguar (dhe diferenca e rivlerësimit)						1,716,946		1,716,946
Primet e aksioneve								-
Rezervat						131,581		

								131,581
Fitimet e pashpërndara		-	-			(387,345)		(387,345)
Fitimi i vitit në vazhdim	-		-	-	12,124			12,124
TOTALI	1,325,392	316,702	371,191	1,281,952	1,359,582	1,679,248	1,040	6,335,106

12. Kapitali Rregullator

KAPITALI RREGULLATOR PËR MBULIMIN E RISQEVË TË KREDISË	31 Mars 2015	31 Dhjetor 2014
KAPITALI BAZË		
I. Elementet Përbërëse që Shtohen (A):		
1. Kapitali Nënshkruar (5711)	1,762,717	1,762,717
2. Rezervat (përvec rezervave të rivlerësimit) (5731, 5733, 5734)	131,581	131,581
3. Primet e emetimit dhe të fuzionimit (572)	-	-
4. Fitimet e pashpërndara (e bartura) (577(P))		
5. Fitimi ushtrimor i fundit të vitit (578(P))	-	-
6. Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese (578(P))	-	-
7. Diferenca rivlerësimi kreditore (574(P))	-	-
Nëntotali A=(1+2+3+4+5+6+7)	1,894,297	1,894,297
II. Elementet Përbërëse që Zbriten (B):		
1. Kapitali Nënshkruar i Papaguar (5712)	-	-
2. Vlera nominale e aksioneve (të pashitura, të riblera)	-	-
3. Humbjet e pashpërndara (të bartura) (577(-P))	405,958	405,958
4. Humbja ushtrimore (578(-P))	-	-
5. Diferenca rivlerësimi debitore (negative) (574(-P))	45,771	248,182
6. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara (531-5371)	4,335	4,396
Nëntotali B=(1+2+3+4+5+6)	456,064	658,537
Totali Kapitalit Bazë C=(A-B)	1,438,233	1,235,761
KAPITALI SHITESË		
III. Elementet Përbërëse (J):		
1. Rezervat e rivlerësimit (EA) (5732)	-	-
2. Rezerva të përgjithshme (EB)	-	-
3. Istrumente hibrid (EC) (56)	-	-
4. Detyrime të varura me afat (F) (56)	-	-

nqs $F \leq C/2$ atëherë $G=F$; nqs $F > C/2$ atëherë $G=C/2$	-	-
Nëntotali i kufizuar $H=(EA+EB+EC+G)$:	-	-
(J) nqs $H \leq C$ atëherë $J=H$; nqs $H > C$ atëherë $J=C$	-	-
Totali i Kapitalit Shtesë para zbritjes (J)	-	-
IV. Elementet Përbërëse që Zbriten (P+Q+V):		
1. Pjesëmarrje në banka e institucione financiare (P):		
(K) Pjesëmarrje $>10\%$ në kapitalin e tyre ose $<10\%$ por që ushtron një ndikim të rëndësishëm mbi to + Të Drejtat e Varura në të njëjtën bankë ose inst.fin.	-	-
(L) Shuma e Pjesëmarrjeve që nuk plotësojnë kushtet e mësipërme, plus të Drejtat e Varura të tjera ndaj të njëjtave banka ose inst.fin. u zbriten 10% të Fondeve të Veta (C+J):	-	-
$M=(C+J)*10\%$	-	-
mbetur pas zbritjes: $N=(L-M)$ nqs >0	-	-
Nëntotali $P=(K+N)$	-	-
2. Garancitë e dhëna Fondeve të Garancive Reciproke sipas kushteve të BQ (Q)	-	-
3. Aktet rregullatore të Bankës së Shqipërisë (V) $V = V1+V2+V3+V4$	-	-
-rregullorja "Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare", miratuar me vendim të KMBSH nr.42, datë 06.06.01 (V1)	-	-
-rregullorja "Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal për veprimtaritë e lejuara të bankave dhe degëve të bankave të huaja të liçencuara", miratuar me vendim të KMBSH nr.51, datë 22.04.99 (V2) $V2 = AQT - 25\% (C+J)$, nëqoftëse $V2 > 0$.	-	-
-rregullorja "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", miratuar me vendim të KMBSH nr.31, datë 30.04.08 (V3)		
-rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendim të KMBSH nr.61, datë 29.08.2008 (V4)	-	-
Nëntotali i pjesës që zbritet është (P+Q+V)	-	-
Llogaritja Përmbledhëse e Kapitalit Bazë dhe Kapitalit Shtesë pas zbritjes IV:		
nqs $J \leq (P+Q+V)$ atëherë:		
kapitalit shtesë pas zbritjes $JA=0$; ne te kundert $JA=J-(P+Q+V)$	-	-
kapitalit bazë $CA=C+J-(P+Q+V)$; ne te kundert $CA=C$	1,438,233	1,235,761
TOTALI I KAPITALIT BAZË DHE KAPITALIT SHITESË: $E=(JA+CA)$	1,438,233	1,235,7651

13.Zerat e Aktivit te ponderuar me rrezikun

Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik (në mijë lekë)		Shuma
1. Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	(a)	3,359,760.57
2. 12.5 * kërkesa për kapital për rrezikun e tregut	(b)	89,572.26
3. 12.5 * kërkesa për kapital për rrezikun operacional	(c)	285,732.5
4. Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	(d)	0
5. Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2015	(e)	187,584.82
(TOTAL) Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(a+b+c+d-e)	3,547,480.52

Formulari 15/2

Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, duke i bazuar klasat në "veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "veprimet me letrat me vlerë" jorezidente në valutë (në mijë lekë)		Shuma
1. Totali i zërave të aktivit "veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	(a)	1,942,692.42
2. Totali i zërave të aktivit "veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "veprimeve me letrat me vlerë", jorezidente në valutë në periudhën raportuese	(b)	1,699,648.6
3. Rritja e zërave të aktivit "veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare" dhe i "veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidente, në valutë	(c) = (b) - (a)	(243,043.82)
4. Totali i zërave të pasivit "veprimeve me thesarin dhe transaksionet	(d)	12.01

ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve në valutë, mars 2013		
5. Totali i zërave të pasivit “veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve, në valutë në periudhën raportuese	(e)	36,300.1
6. Rritja e zërave të pasivit “veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë	(f) = (e) - (d) (g) = 0 nëse (c) ≤ 0; (g) = (c) nëse (f) < 0; (g) = (c) - (f) nëse (f) > 0	36,288.11
7. Shtesa e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik		0

Formulari 15/3

Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit (në mijë lekë)		Shuma
1. Portofoli i kredisë bruto, dhjetor 2014	(a)	1,875,848.24
2. Portofoli i kredisë bruto në periudhën raportuese, 2015	(b)	1,930,781.30
3. Rritja e portofolit të kredisë 2015	(c) = (b) - (a)	54,933.06
4. Rritja e portofolit të kredisë për 2015-ën, me bazë vjetore sipas periudhës raportuese:		
4.1 nëse periudha raportuese është mars 2015	(d) = (c) * 4	219,732.24
4.2 nëse periudha raportuese është qershor, 2015	(d) = (c) * 2	-
5. 4% e portofolit të kredisë së dhjetorit, 2014	(e) = (a) * 4%	75,033.93
6. 10% e portofolit të kredisë së dhjetorit, 2014	(f) = (a) * 10%	187,584.82

7. Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik vetëm për periudhën raportuese 2015	(g) = 0 nëse (d) < (e) ; (g) = (d) nëse (e) < (d) < (f) ; (g) = (f) nëse (d) > (f)	187,584.82
--	--	------------

14. Raporti i mjaftueshmerise se kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (në mijë lekë)	Shuma	
1. Kapitali rregullator	(a)	1,438,232.94
2. Aktivët dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(b)	3,547,480.52
3. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (2/1)*100	((a)/(b))*100	40.5

15. Krahasimi i Madhësisë të kapitalit Rregullator të Bankës me Kërkesën për kapital Rregullator për mbulimin e Riskut të Tregut të lidhur me normat e interesit

Krahasimi i Madhësisë të Kapitalit Rregullator të Bankës me Kërkesën për Kapital Rregullator për mbulimin e Riskut të Tregut të lidhur me normat e interesit		31 Mars 2015	31 Dhjetor 2014
Treguesit (në mijë leke)			
A) Madhësia e kapitalit rregullator (X)			
sipas Formularit 2: X=D+W		1,438,233	1,235,761
B) Kërkesa për kapital rregullator (Y)			
1. për Portofolin e Tregtueshëm:			
sipas Formularit 5 për riskun e normave të interesit (VA)		-	-
për riskun e ndryshimit të cmimit të tregut të titujve me të ardhura variabël (VB)		-	-
për riskun e rregullimeve të shlyerjes me kunderpartine (VC)		-	-

për riskun e tejkalimeve të limiteve për risqet e mëdhenj (VE)			-	-
2. për Këmbimet në Valutë (VD)			7,166	5,244
Shuma e tyre: VF=(VA+VB+VC+VD+VE)			7,166	5,244
Kërkesa Totale për Kapital Rregullator: Y=D+VF			413,920	364,809
C) Krahasimi i (A) me (B):				
Norma e Përgjithshme e Mbulimit: Z=100*(X/Y)			347%	339%
Norma e Përgjithshme Minimale (100%)			100%	100%

16. Kërkesa për Kapital rregullator për mbulimin e Riskut të Tregut të lidhur me këmbimet në valute

Kërkesa për Kapital Rregullator për mbulimin e Riskut të Tregut			31 Mars 2015	31 Dhejtor 2014
të lidhur me Këmbimet në Valutë	Pozicioni	Ponderimi	Kërkesa për	Kërkesa për
Treguesit (në mijë leke)	Neto		Kap.Rregull.	Kap.Rregull.
A) Krahasimi ndermjet:				
Pozicionit Neto Global (VD1)	89,572			
2% e Kapitalit Rregullator Global (XA)	28,765			
B) Kërkesa për kapital rregullator (VD)				
nqs VD1>XA atëherë VD=VD1-XA	60,808	8%	7,166	5,244

17. Shenime

Hyrje

1. Informacion i pergjithshem

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (referuar më poshtë si “Banka” ose “UBA”) është krijuar në Shqipëri për të zhvilluar veprimtari bankare në përputhje me legjislacionin Shqiptar. Bazuar në nenet e Statutit të saj, Banka ndjek Parimet Sharia. Aktivitetet e Bankës përfshijnë veprimtarinë si administruese, mbi bazën e mirëbesimit, të fondeve të investuara në përputhje me parimet dhe ligjet Islamike. Banka është subjekt i Ligjit Nr. 9662 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006 dhe nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë.

Në 5 nëntor 1992, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare. Procedurat e regjistrimit përfunduan në 1 korrik 1994, data e themelimit. Në 11 janar 1999, në përputhje me Vendimin Nr.165, të datës 11 dhjetor 1998 të Bankës së Shqipërisë, Banka mori licensën “Për vazhdimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Ligjin Nr. 8365, të datës 2 korrik 1998, “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Aksioneret kryesore janë :

Banka Islamike per Zhvillim, Jeddah	86.7%
Ithmaar Bank B.S.C.	4.63%
Dallah Albaraka Holding Co	2.32%
Investitorë të tjerë - Arabia Saudite	6.35%

Qendra e Bankës është vendosur në Tiranë. Aktualisht Banka ka një shpërndarje të aktivitetit në 4 qytetet Tirane, Shkoder, Fier dhe Durres si dhe ka dy agjenci të vendosura në Tiranë. Më 31 Mars 2015 numri i të punësuarve është 72 (2014: 72).

1. a Vlerësimi i menaxhimit për aftësinë për vazhdimësi të aktivitetit

Banka ka pësuar humbje gjatë viteve të fundit financiare Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e kapitalit, të limitohen risqet nga ekspozimet e mëdha dhe për vazhduar aktivitetin e saj, në vitin 2011, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, vendosi të përthithte humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2010 dhe të rriste kapitalin e paguar.

Pas injektimit të kapitalit shtesë, Manaxhimi beson që aftësia e Bankës për të vazhduar aktivitetin nuk çënohet. Për këtë arsye, Banka i ka përgatitur të dhenat financiare mbi bazat e vazhdimësisë së biznesit.

1. Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e Raportimit dhe përmbajtjen e raportimit financiar” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF është aprovuar për qëllime rregullatore, në përputhje me Nenin 47 të Ligjit Nr 9662, të datës 18 dhjetor 2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë” (“Ligji Bankar”).

2. Politikat kryesore kontabile

(a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, dhe janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve të marra nga procest gjyqësore, të cilat janë të matura me vlerën reale.

(b) Arka dhe mjete monetare të ngjashme

Arka dhe mjetet monetare të ngjashme përfshijnë gjendjen e arkës, balancat me Bankën Qëndrore (përveç rezervës së detyrueshme) si dhe balancat me bankat dhe institucionet e tjera financiare me date shlyerje dhe norme interesi të paracaktuar.

(c) Te drejtat prej aktiviteteve financuese (Murabaha)

Murabaha dhe të tjera të pagueshme regjistrohen në bilanc pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulim humbjesh nga kreditë. Murabaha dhe të tjera të pagueshme janë të njejta me huatë dhe paradhëniet për klientët.

Fondet rezervë për mbulim humbjesh janë krijuar në përputhje me rregulloren Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë” (Rregullorja e Re e Kredisë), e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më 14 shtator 2011. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë ekspozimet në kategori rreziqesh të mëposhtme. Për çdo kategori të rrezikut, aplikohen normat e fondeve rezervë si më poshtë:

LLOJI I HUASË	NORMA E FONDIT
Standarde dhe jo të kthyera në afat	1%
Në ndjekje	5%
Nën standard	Jo me pak se 20%
Të dyshimta	Jo me pak se 50%
Të humbura	Jo me pak se 100%

Shumat për financimet e dhëna raportohen neto, pas zbritjes së fondeve rezervë për aktivitetet financuese që klasifikohen si nënstandard, të dyshimta dhe të humbura. Fondet e krijuara për humbjet e mundshme nga aktivitetet financuese që klasifikohen si standarde dhe në ndjekje, regjistrohen si provigjion statistikor në anën e detyrimeve të bilancit kontabël. Banka nuk përllorarit të ardhura për kreditë me probleme

(d) Bono Thesari

Bono Thesari-të mbajtura-deri në maturim

Keto Bono thesari kontabilizohen me cmimin e blerjes dhe me te ardhuren e përlllogaritur për kuponat që do të paguhen. Cdo zbritje apo prim i përfituar mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përlllogaritur deri ditën e maturimit dhe pagesës. Këto Bono Thesari konsiderohen si të mbajtura deri në maturim meqenese Banka ka ndërmend t'i mbajë ato në baza të afatgjata deri në maturitet. Provigjionimi kontabilizohet kur ka gjasa të mëdha që Banka nuk i zotëron dot këto letra deri në maturim për shkak të rrethanave të reja, ose në qoftë se ka një risk të dështimit nga lëshuesi i letrës me vlerë.

(e) Investime ne Mudaraba

Investimet ne Mudaraba jane bashkepjesemarrje, ku Banka luan rolin e investitorit me kapital per sipermarresin ('Mudarib') me qellim marrjen pjese ne nje aktivitet investues. Kur shuma e investimit pritet te jete me e ulet se vlera kontabel ne terma afatgjata e investimit, provigjonet nga zhvleresimet njihen si fitim/humbje.

(f) Aktive të qëndrueshme

Aktive të qëndrueshme paraqiten me koston e tyre pasi të jetë zbritur zhvlerësimi i akumuluar, i cili është i përlllogaritur në baza lineare mbi jetëgjatesinë e vlerësuar të përdorimit të aktiveve. Jetëgjatësite e vlerësuara, përdorur për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë

- Ndërtesa 20 vite
- Automjete 5 vite
- Pajisje zyre 5 vite
- Kompjuterat dhe pajisje elektronike 4 vite
- Mobilje dhe pajisje 5 vite
- Aktive te paprekshme 4 vite

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia e përdorshme dhe vlerat e mbetura rishikohen në cdo fund të vitit financiar dhe rregullohen në qoftë se është e nevojshme.

Kostot për riparimet në ambientet me qira, janë të përfshira në aktive të tjera si "Shpenzime që amortizohen nëpër vite" dhe janë të amortizueshme për pesë vjet.

(g) Aktive të marra përmes proceseve gjyqësore

Aktivet e marra nëpërmjet proceseve gjyqësore përbëhen nga kolaterat e marra nga banka për kreditë e humbura. Këto aktive mbahen si pronësi investuese dhe rivlerësohen mbi baza të rregullta me referencë me cmimet e tregut. Vlera kontabël e këtyre aktiveve përafëron vlerën e tyre aktuale të tregut.

(h) Llogaritë e klientëve

Llogaritë e klientëve në princip përfshijnë depozitat e vecanta investuese ku depozituesit udhëzojnë Bankën për të investuar fondet e tyre në investime të

vecanta ose me kushte të paracaktuara. Këto depozita investohen nga Banka nën emrin e saj nën kushtet e kontratave specifike Mudareb të nënshkruara me depozituesit. Këto depozita specifike investuese, të cilat janë të klasifikuara brenda llogarive të klientëve, ndajnë fitimin ose humbjen direkte të investimeve të tyre përkatëse në momentin e realizimit, dhe përndryshe nuk marrin pjesë në fitimin ose humbjen e Bankës.

(h) Shpërndarja e fitimit për klientët

Fitimi i Bankës shpërndahet ndërmjet depozituesve dhe aksionerëve të Bankës në përputhje me parimet e Shariatit Islamik duke përdorur metodën kryesore në grup. Depozituesve ju shpërndahet në llogaritë e tyre pjesa që ju takon nga fitimi në përputhje me maturitetet e kontraktuara të investimeve.

(i) Regjistrimi i të ardhurave

Të ardhura nga bankat dhe institucione të tjera financiare

Të ardhurat nga bankat dhe institucionet e tjera financiare regjistrohen mbi bazë përlllogaritjeje.

Kontratat Murabaha.

Të ardhurat nga kontratat Murabaha regjistrohen mbi bazë përlllogaritjeje.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve dhe komisionet janë ato që përftohen nga shërbimet financiare të ofruara nga Banka duke përfshirë shërbimet e menaxhimit të mjeteve monetare, të ndërmjetësimit si dhe ato si këshilltar investimi. Të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe komisionet regjistrohen kur ofrohet shërbimi përkatës.

(j) Tatimi

Banka e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Në vitin 2013, tatimi mbi fitimin është 10% mbi të ardhurat e tatueshme. Tatim fitimi i pagueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të caktuar të të ardhurave dhe të shpenzimeve sic kërkohet nga Legjislacioni Shqiptar. Fitimi statutor bazohet në regjistrimet kontabël të mbajtura nga Banka për qellime të Standardeve Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe mund të ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga raportimi i pozicionit financiar për qellime rregullatore në përputhje me MRF.

(k) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin e këmbimit valutor të datës kur është kryer transaksioni. Aktivitetet dhe pasivitetet monetare të shprehura në monedha të huaja në datën e bilancit, janë konvertuar në monedhën matëse me kursin e këmbimit të asaj dite. Diferencat që rrjedhin nga këmbimet valutore regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivitetet dhe pasivitetet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën matëse me kurset e këmbimit valutor të ditës kur janë kryer transaksionet.

Kapitali aksioner është trajtuar si një zë monetar dhe rivlerësohet në përputhje me politikën e sipërpërmendur. Sipas kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë kapitali në monedhë të huaj duhet të kontabilizohet në bilanc me kursin e ditës kur është kryer transaksioni dhe një zë “Rezervë Rivlerësimi” krijohet në grupin e kapitalit dhe përfaqëson diferencën midis kursit fiks të Bankës së Shqipërisë të fund vitit me kursin historik me të cilin është regjistruar

kapitali në monedhë të huaj.

(I) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të bëjnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë direkt në aplikimin e politikave kontabile dhe në vlerat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Treguesit aktualë mund të ndryshojnë nga ata të parashikuar.

3. Administrimi i rrezikut financiar

Instrumentet financiare shkaktojnë një sere rreziqesh me të cilat Banka perballlet çdo ditë gjatë aktivitetit të saj. Për administrimin e këtij rreziku, Banka ka hartuar politika që identifikojnë dhe analizojnë rreziqet në mënyrë që të vendosen limitet e duhura të këtyre rreziqeve, kontrollet dhe monitorimet në përputhje me këto limite. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet që ofrohen. Gjatë vitit 2013 Banka ka ristrukturuar Dept. duke specifikuar qartë detyrat dhe rolin e çdo punonjësi të këtij departamenti. Rreziqet kryesore që Banka është e ekspozuar nga përdorimi i instrumentave financiare janë:

3.1 Rreziku i likuiditetit

Është rreziku që Banka mund të ketë vështirësi për të siguruar fonde për të plotësuar detyrimet që burojnë nga instrumentat financiare dhe për të ruajtur vazhdimësinë e biznesit. Banka monitoron në baza ditore depozitat e klienteve dhe detyrimet kur ato do paguheshin dhe siguron fonde të aktiveve të saj duke mbajtur një kapacitet të kënashëm për kryerjen e pagesave. Banka nëpërmjet komitetit ALCO monitoron vazhdimisht rrjedhjet e pritshme të parave duke i sinkronizuar me momentet e arkitimeve nga investimet e saj. Në bazë të rregullores së BSH, Banka mban një limit të raportit të likuiditetit që është 15% për çdo monedhë dhe 20% në total, të cilat ndiqen rigorozisht. Gjithashtu Banka duhet të mbajë pranë BSH Shumen prej 10% të depozitave si reserve të detyruara. Gjatë tremujorit të dytë të vitit, treguesit e likuiditetit të Bankës (të përlogaritur sipas kërkesave rregullatore të Bankës së Shqipërisë) kanë qenë vazhdimisht më të larta se nivelet minimale të kërkuara nga BoA. Në fund të muajit Shtator 2014 aktivet likuide ishin 2,066,378 mijë lekë ndërkohë që pasivet afatshkurtra ishin 4,616,395 mijë lekë. Mesatarisht, gjatë kësaj periudhe të vitit 2014, raporti i aktiveve likuide në lekë ndaj pasiveve afatshkurtra ka qenë mbi 40%. I njëjti raport për monedhat e huaja ka qenë rreth 30%. Treguesi total, i cili përfshin të gjitha monedhat ka qenë në një nivel rreth 38%

3.2 Rreziku i kredise

Rreziku që Banka mund të pesojë humbje si rezultat i pamundësisë së ripagimit të detyrimit nga pala tjetër e një instrumenti financiar. Banka është subjekt i rrezikut të kredisë gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj kreditues si dhe në rastet kur ajo vepron si një ndërmjetës në emër të klientëve ose palëve të treta ose kur lëshon garanci. Në këtë kuptim, rreziku i kredisë për Bankën vjen për shkak të mundësisë që palët e tjera të dështojnë në plotësimin e detyrimeve të tyre kontraktuale. Menaxhimi i rrezikut të kredisë për huatë e dhëna huamarrësve bëhet nëpërmjet analizave të rregullta të përshtatshmërisë së huamarrësit për të marrë kredi si dhe nëpërmjet klasifikimit të kredive në disa kategori. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet gjithashtu nëpërmjet marrjes së kolateralit dhe garancive. Llojet kryesore të kolateraleve janë :

- Prona hipotekore ose rezidenciale
- Pengjet mbi aktivet e bizneseve ose te individeve
- Depozita - (kolaterale monetare)
- Garante personale per kredine

Banka administron rregullisht ekspozimin ndaj rrezikut te kredise duke monitoruar limitin e shumes se financuar, sektorin dhe portofolin ne teresi.